



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 252 / Prot.  
3

Tiranë, më 15 / 104 / 2015

VENDIM

Nr. 29 , datë 15 / 104 / 2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ z. ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 252 Prot., datë 30.03.2015, ndaj Autoritetit Publik/ Institutit të Monumenteve të Kulturës, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*". Ankuesi/ z. në cilësinë e kërkuarit, ka paraqitur pranë autoritetit publik/ Institutit të Monumenteve të Kulturës, kërkesën datë 11.03.2015, me objekt "*Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit*", nëpërmjet të cilës ka kërkuar t'i vihen në dispozicion dokumentacioni i mëposhtëm:

- 1) Një kopje të procesverbalit të mbledhjes së institucionit datë 05.03.2015, sa i përket diskutimeve në lidhje me Manastirin e Shën Kollit, në Mesopotam Sarandë.
- 2) Një kopje të projektit të miratuar nga ana e institucionit tuaj më datë 05.03.2015, në lidhje me Manastirin e Shën Kollit, në Mesopotam Sarandë.

Instituti i Monumenteve të Kulturës, me anë të shkresës nr. 355/1, datë 23.03.2015 i ka kthyer përgjigje kërkuarit duke argumentuar se:

- 1) Bazuar në pikën 4 të nenit 3 të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.
- 2) Për sa i përket kopjes së projektit të miratuar nuk merret në konsideratë pasi platformat e paraqitura nga kandidatët nuk janë dokumente zyrtare.
- 3) Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Restaurimit, dt 05.03.2015 përmban diskutime dhe ka të dhëna personale për projektin e miratuar.

Komisioneri, pas vlerësimit të ankesës, me urdhrin nr.67, datë 07.04.2015, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/ Institutit të Monumenteve të Kulturës. Gjatë inspektimit, koordinatori i Institutit të Monumenteve të Kulturës argumentoi se kopja e procesverbalit nuk i është vënë në dispozicion kërkuarit, pasi kufizohet nga neni 17 pika 2

gërma e) e ligjit 119/2014, "Për të drejtën e informimit". Lidhur me kërkesën për kopje të projektit të miratuar nga Autoriteti Publik/Instituti i monumenteve të Kulturës, koordinatori shpjegoi se dhënia e këtij dokumentacioni kufizohet nga ligji nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të drejtën e autorit".

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit të ankesës së Z. , përgjigjes së Autoritetit Publik si dhe shpjegimeve të koordinatorit të Autoritetit Publik/ Institutit të Monumenteve të Kulturës, konstaton se, referencat ligjore nuk qëndrojnë dhe nuk justifikojnë mospërbushjen e detyrimit të Autoritetit Publik për dhënie të dokumentacionit të kërkuar.

Bazuar në gërmën "gj" të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", informacioni i kërkuar konsiderohet publik dhe si tillë duhet vënë në dispozicion të kërkuarit.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit",

### **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankesës nr. 248 Prot., datë 27.03.2015 të z.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Institutit të Monumenteve të Kulturës për të dhënë informacionin/dokumentacionin e kërkuar ankuesit brenda datës 24.04.2015.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Ky vendim u dha sot në datë 15.04.2015.

**Besnik DERVISHI**  
KOMISIONERI

